

SHP TETOVË

EKSKURSIONI NË SARAJEVË NDJESI E VEÇANTË E PENSIONISTËVE TETOVAR

Midis tjerash u vizitua lokaliteti i Bashçarshisë-pazari i vjetër dhe zemra historike e qytetit. Aroma e kafesë boshnjake dhe zhurma e duarve të mjeshtërve zanatlinj i jepnin gjallëri këtij lokaliteti

Kah mesi i muajit të kaluar, bazuar në Programin vjetor të Komisionit për jetë kulturore e zbavitëse të pensionistëve të SHP Tetovë, 120 pensionistë ishin pjesëmarrës të ekskursionit katërditor në qytetin e Sarajevës të Bosnjë e Hercegovinës. Ishte ky ekskursioni i parë i realizuar jashtë vendit, me participim të vetë pjesëmarrësve, në kuadër të të cilit, pensionistët tetovar gjatë rrugëtimit për në destinacionin e caktuar, kishin mundësi të vizitojnë qytete e vendbanime të Kosovës, Shqipërisë, Malit të Zi, Bosnjë e Hercegovinës dhe Serbisë.

Pas shumë orësh udhëtimi, pjesëmarrësit me të arritur në Sarajevë u akomoduan në hotel me kushte të mira qëndrimi dhe me ushqim cilësor. Dalja nëpër rrugët e qytetit të Sarajevës dhe vizitat e bëra tek shumë monumente kulturore e historike, dëshmoi se ky qytet është njëri nga vendbanimet më të veçanta në Ballkan, ku ndërthurren kultura lindore e perëndimore në mënyrë harmonike. Këto karakteristika menjëherë i ranë në sy pensionistëve te-



tovar, të cilët shijuan bukuritë e mahnitshme të lokaliteteve që u vizituan.

Një ndihmesë të madhe për t'u njohur me historinë e qytetit, të kaluarën, traditat, monumentet e kulturës mundësuan udhërrëfyesit e përgatitur, të cilët gjatë gjithë kohës kanë qëndruar pranë pensionistëve tetovar, për t'u shpjeguar gjithçka që është karakteristike e këtij qyteti të lashtë.

Midis tjerash u vizitua lokaliteti i Bashçarshisë-pazari i vjetër dhe zemra historike e qytetit. Aroma e kafesë boshnjake dhe zhurma e duarve të mjeshtërve zanatlinj i jepnin gjallëri këtij lokaliteti. Aty pranë u vizitua edhe lokaliteti ku më 28 qershor 1914 filloi lufta e parë botërore, si pasojë e vrasjes së austriakut Franc Ferdinand nga serbo-boshnjaku Gavrillo Princip. Ky ishte njëri ndër shkaqet e fillimit të luftës, e cila më vonë mori përmasa botërore.

Një lokalitet tjetër mjaft i njohur që u vizitua nga pensionistët tetovar në kryeqendrën boshnjake ishte edhe loka-

liteti Ilixha, i njohur për bukuritë natyrore, trashëgiminë historike dhe mundësi pa kufi për relaksim. Ky vend është një destinacion i preferuar për ata që duan të shijojnë natyrën dhe të mësojnë më shumë rreth historisë së rajonit. Pensionistët tetovar pjesëmarrës të këtij ekskursioni mbetën tejet të kënaqur nga ajo që panë e shijuan në këtë lokalitet.

Pas ekskursionit katërditor në Sarajevë, të gjithë pensionistët pjesëmarrës u kthyen në Tetovë, duke gëzuar shëndet të plotë. Nga deklaratimet e një pjese të pjesëmarrësve, mund të kuptohet se ky ekskursion ishte tejet i rëndësishëm, madje për disa historik, pas të cilit do të mbeten shumë kujtime e mbresa nga ajo që u vizitua. Fotografitë dhe inçizimet e realizuara nga pjesëmarrësit, një kohë të gjatë do të rikujtojnë lagjet e vizituara në Sarajevë, por edhe shumë qytete e vendbanime të sheteteve nëpër të cilët kaluam për realizimin e këtij ekskursioni katërditor. M. Murseli

SHPP GAZI BABË



Aktivitetet e pensionistëve të Gazi Babës

Tre degë të Shoqatës së Pensionistëve të Gazi Babës kohët e fundit organizuan një ekskursion njëditor në Ohrin e mrekullueshëm, Jerusalemin e Maqedonisë. Në një atmosferë të këndshme dhe shoqërore, pensionistët shijuan bukuritë e qytetit dhe shëtitjen buzë liqenit. Gjithashtu, ata vizituan monumentet kulturore dhe historike, në një shoqërim të ndërsjellë që la përshtypje të forta dhe shumë kujtime. Pensionistët nga tre degë të Shoqatës së Pensionistëve të Gazi Babës vizituan manastirin e njohur gjerësisht të Shën Naumit dhe Plashnikun, ku është themeluar universiteti i parë nëpër të cilin kanë kaluar mbi 300 nxënës. Në kuadër të aktiviteteve, më 1 korrik të këtij viti u mbajt edhe mbledhja e Bordit Ekzekutiv të shoqatës, në të cilën u morën vendime të rëndësishme në interes të anëtarëve të shoqatës, të orientuara drejt përmirësimit të jetës së tyre sociale, organizimit të ngjarjeve të reja dhe avancimit të veprimit të përbashkët në periudhën e ardhshme. Më 10 korrik, në një atmosferë të këndshme, u mbajt një takim edukativ i pensionistëve të SHP Gazi Babë me përfaqësues të Ministrisë së Punëve të Brendshme, me temën "Mbrojtja nga mashtrimet".

Të pranishmit patën mundësinë të dëgjojnë këshilla dhe rekomandime të dobishme se si të mbrohen nga përpjekjet gjithnjë e më të shpeshta për mashtrime dhe dezinformata, veçanërisht ato që janë të drejtuara ndaj popullatës më të moshuar. Falënderim i madh për MPB-në për mbështetjen dhe angazhimin për sigurinë e anëtarëve tanë. SHP Gazi Babë vazhdon të punojë në mënyrë aktive për të mirën e anëtarëve të vet, duke u ofruar atyre një program të pasur dhe mundësi për shoqërim, rekreacion dhe plakje aktive. Stojna Todorovska

Në vend ekzistojnë 5 shtëpi shtetërore për të moshuar me kapacitet prej 600 shtretërish, ndërsa në listën e pritjes janë rreth 250 pensionistë. Shtëpitë janë të mbipopulluara dhe në to janë të vendosur gjithsej 837 pensionistë

Lidhja e Shoqatave të Pensionistëve të Maqedonisë ka bërë një analizë të gjendjes me shtëpitë e të moshuarve, shtëpitë e pensionistëve dhe shërbimet sociale në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

Në vend ekzistojnë 5 shtëpi shtetërore për të moshuar me kapacitet prej 600 shtretërish, ndërsa në listën e pritjes janë rreth 250 pensionistë. Shtëpitë janë të mbipopulluara dhe në to janë të vendosur gjithsej 837 pensionistë. Çmimet për akomodim variojnë nga 9.711 deri në 22.000 denarë.

GJENDJA ME SHTËPITË E TË MOSHUARVE DHE SHËRBIMET SOCIALE NË RMV SHTËPITË E TË MOSHUARVE NË VEND TË MBIPOPULLUARA



Për dallim nga shtëpitë shtetërore, prej kohësh nuk është ndërtuar asnjë shtëpi e re, ndërsa shtëpitë private vazhdimisht hapen dhe për momentin ekzistojnë mbi 40 shtëpi, kryesisht në Shkup, në të cilat janë të vendosur mbi 1.200 persona. Çmimet për akomodim janë trefish më të larta sesa në shtëpitë shtetërore dhe nisin nga 40.000 denarë e më lart.

Në periudhën nga vitet 60-ta deri në 90-ta të shekullit të kaluar, në shtet u ndërtuan disa shtëpi për

pensionistë me mjete të ndara për ndërtimin e banesave nga kontributet për sigurim pensional dhe invalidor.

Në këto shtëpi pensionale, përveç hapësirave afariste, klubeve për pensionistë dhe hapësirave të tjera, ka edhe dhoma për pensionistë. Në këto dhoma strehohen përfutues të pensionit me të ardhura të ulëta pensionale, të cilët paguajnë shuma minimale për akomodim.

Fondi i Sigurimit Pensional dhe Invalidor i Maqedonisë së Veriut

administron me 14 shtëpi pensionale me gjithsej 471 dhoma, në të cilat janë të vendosur 421 pensionistë. Çmimet variojnë nga 600 deri në 1.400 denarë.

Shoqatat e pensionistëve anëtare të LSHP-së disponojnë me 155 dhoma, në të cilat janë të vendosur 134 përfutues të pensionit. Sipas udhëzimeve të dhëna, këto dhoma përdoren ekskluzivisht për pensionistë. Çmimet variojnë nga 650 deri në 3.000 denarë.

Ekzistojnë edhe shtëpi dhe dhoma të tjera, kryesisht për qëllime rekreative. Në shumë qytete funksionojnë "Qendra për ndihmë dhe kujdes për të moshuar në shtëpitë e tyre", kryesisht si projekte të mbështetura nga komunat ose me donacione të huaja, ku punojnë persona të trajnuar dhe vullnetarë. Ky është një model modern për kujdesin ndaj përfutuesve të pensionit dhe është i përshtatshëm për pensionistët, por vjen një

kohë kur përfutuesi i pensionit ka nevojë të vendoset në një shtëpi të të moshuarve ku ofrohet kujdes dhe vëmendje e plotë. Prandaj është e domosdoshme të ndërtohen shtëpi shtetërore për të moshuar, pasi është fakt që numri i personave të moshuar po rritet me shpejtësi.

Në mbledhje, pas diskutimit, u konstatua se informacioni është gjithëpërfshirës dhe përbën një analizë të mirë të gjendjes që duhet përmirësuar sa më shpejt. Ky informacion do t'i dorëzohet Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe Ministrisë për Politikë Sociale, Demografi dhe Rini. Shteti duhet të ndërmarrë masa urgjente për kujdesin ndaj të moshuarve, sepse një numër gjithnjë e më i madh i tyre mbeten të vetmuar si në qytete, ashtu edhe në zonat rurale, për shkak të emigrimit të rinjve nga vendi. LSHPM